



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’ Ark” Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)  
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

## **RAPORT MONITORIMI**

### **MBI PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**ZHVILLUAR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKES NË DATËN 05.12.2019**

Tiranë, Dhjetor 2019

## *Hyrje*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar kompetenca të Avokatit të Popullit, që lidhen me procedurat e krijimit dhe funksionimit të disa organeve të reja, shumë të rëndësishme për ecurinë dhe mbarëvajtjen e Reformës në Drejtësi, midis të cilave edhe të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në frymën e përçarur nga Kushtetuta, në dispozitat që lidhen me Reformën në Drejtësi, Avokatit të Popullit i jepen kompetenca «atipike», dhe në vijim të kompetencave që atij i jepen nga Ligji organik, nr.8454 datë 4.02.1999 « Për Avokatin e Popullit », i ndryshuar.

Avokati i Popullit, si institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutë, për mbrojtjen, parandalimin e shkeljes dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, vlerëson Reformën në Drejtësi, si reformën më të rëndësishme për ecurinë dhe zhvillimin sistemit demokratik në Shqipëri. Reforma në Drejtësi ka marrë fokus të vecçantë në punën e institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm për shkak të detyrimeve ligjore të përcaktuara në legjislacion, por edhe për shkak të vet rëndësisë që mbart kjo reformë, që lidhet drejtëpërdrejtë dhe pazgjidhshmërisht me me respektimin e të drejtave të njeriut në vend.

Avokati i Popullit nuk mund e nuk duhet të shihet si i pakonsiderueshëm për suksesin e procesit të zbatimit të kësaj reforme, që në vetvete mbart dy qëllime kryesore, luftën kundër “koorporatizmit” dhe transparencën e plotë në vendimarrje, për të siguruar besueshmërinë e pritshme dhe të nevojshme për sistemin e drejtësisë në vend. Nën këtë përgjegjësi, Avokati i Popullit ka qënë dhe vazhdon të jetë në mbështetje të plotë të zbatimit të Reformës në Drejtësi, si një reformë jetike për të gjithë shqiptarët, pasi shumë nga çështjet që adresohen nga qytetarët, lidhen me sistemin e drejtësisë në vend, për shkak të një sërë problematikave që kanë rënduar këtë sistem e u bënë shkak për Reformën në Drejtësi .

Për më tepër Avokati i Popullit konsideron si jetësore për të gjithë shoqërinë shqiptare kthimin e besimit në sistemin e drejtësisë dhe për këtë ka dhënë kontributin e tij, në monitorimin e shumë prej proceseve të realizuara në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Duke vlerësuar maksimalisht përfshirjen e institucionit tonë si referencë në disa prej aspekteve të zbatimit të Reformës në Drejtësi, Avokati i Popullit mbetet i mendimit se pa një sistem drejtësie të pavarur, eficient dhe të drejtë, Shqipëria nuk do të ndërtojë dot një ekonomi konkurrense që garanton investimet e brendshme dhe të huaja, një politikë të pastër, një jetë të sigurtë për qytetarët e saj, Shtetin e së Drejtës.

Në dritën dhe përgjegjësinë e lartë të këtij anagazhimi institucional, vlerësojmë se pjesëmarrja dhe monitorimi i këtij procesi dhe për më tepër vlerësimi i raporteve të monitorimit, të përgatitura nga ana e Avokatit të Popullit, duhet të konsiderohen si pjesë e sistemit “check and balance” dhe të trajtohen problematikat, nëse ka, në kuadër të veprimtarisë së organeve që kanë përgjegjësinë dhe detyrimin e mbarëvajtjes së procesit të hedhjes së shortit, për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në vijim po paraqesim raportin e monitorimit për procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të ushtrojë veprimtarinë

gjatë vitit 2020, të zhvilluar në datën 05.12.2019, në sallën “Skënderbej”, në selinë e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

**1. *Kompetenca e Avokatit të Popullit, për monitorimin e procedurës së shortit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.***

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, parashikon në pikën 3, të nenit 149/d, dhe në pikën 11, të nenit 179 (dispozitat kalimtare dhe të fundit), përkatësisht dhe ndër të tjera se:

*“Presidenti i Republikës për zgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 Dhjetor të çdo viti kalendarik, anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED)<sup>1</sup>... Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 Dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 Dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.*

*“Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.*

Gjithashtu, në pikën 6, të nenit 284, të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikohet se:

*“Presidenti i Republikës organizon shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi pa vonesë. Procedurat e shortit dokumentohen nga Presidenti i Republikës. Procedurat e shortit zhvillohen në prani të Avokatit të Popullit, i cili harton dhe bën publik një raport monitorimi mbi procedurën e shortit”.*

Përdorimi i terminologjisë “vëzhgues” dhe “merr pjesë”, për përcaktimin e kompetencës që, Avokati i Popullit ka në procesin e krijimit dhe në funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), është një çështje e rëndësishme dhe thelbësore, pasi roli i vëzhguesit është minimumi i kompetencës që Avokatit të Popullit, i njihet në këtë kuptim, karshi organit të pavarur, të KED-së. Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ka rimarrë dhe detajuar përcaktimet e dhëna më sipër në Kushtetutë, duke qartësuar se, Avokati i Popullit ka rolin dhe kompetencën e vëzhguesit, vetëm për procesin e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së.

Në përputhje me nenin 149/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve

---

<sup>1</sup> Sipas nenit 149/d, pika 1, të Kushtetutës përcaktohet se: “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati”.

profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Ky organ shumë i rëndësishëm, përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 221/1, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ata ushtrojnë detyrën me një mandat një vjeçar, që fillon në datën 1 Janar, të çdo viti kalendarik.

Përbërja e KED-së, si një organ kolegjal prej 9 anëtarësh, përcaktohet në nenin 220, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me përkatësinë:

- 2 (dy) gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,
- 1 (një) gjyqtar i Gjykatës së Lartë,
- 1 (një) prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme,
- 2 (dy) gjyqtarë nga Gjykatat e Apelit,
- 2 (dy) prokurorë nga zyrat e prokurorisë, pranë Gjykatave të Apelit,
- 1 (një) gjyqtar nga Gjykatat Administrative.

Sipas pikës 3, të nenit 220, dhe sipas pikës 7, të nenit 221, të po të njëjtit ligj, krahas anëtarëve të KED-së, zgjidhen edhe anëtarë zëvendësues të tyre, që zëvendësojnë të parët, në rast pamundësie ushtrimi të funksionit, ose në rast të konfliktit të interesit.

Kompetenca parësore kushtetuese dhe ligjore për zhvillimin e procesit të hedhjes së shortit, midis datave 1 dhe 5 Dhjetor të çdo viti kalendarik, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i takon Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Nisur nga proceset e mëparshme të kryera për këtë qëllim nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, kompetenca kushtetuese dhe ligjore e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në datën 5 dhjetor 2019, është ushtruar për herë të parë, nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka nxjerrë Vendimin nr.403 datë 25.11.2019 “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit, për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga Presidenti i Republikës”, duke caktuar zhvillimin e procedurës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në datën 5 dhjetor 2019, ora 12.00”, në sallën “Skënderbej”, në selinë e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim dhe dokumenta të tjerë zyrtarë të rëndësishëm për procesin janë bërë publike, në njoftimin zyrtar të publikuar në faqen “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, që në datën 02 dhjetor 2019, pra para kryerjes së procesit të hedhjes së shortit. Njoftimi publik i kryer në këtë rast vlerësojmë se i ka shërbyer transparencës së zhvillimit

të këtij procesi, garantimit të ligjshmërisë, seriozitetit dhe besimit në proces. Në të përmbahen gjithashtu edhe dokumentat mbi bazën e të cilave do të hidhej shorti, si dhe të gjitha detajet dhe dokumentacioni i përcjellë nga institucionet e ngarkuara nga ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas listave përkatëse të dërguara.<sup>2</sup>

Njoftimi zyrtar për këtë qëllim i është dërguar Avokatit të Popullit, zj. Erinda Ballanca, me shkresën nr.4520 datë 2.12.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Presidentit të Republikës. Shkresa e sipërcituar i është drejtuar gjithashtu, edhe anëtarit me kompetenca të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, zj. Vitore Tusha, Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, zj. Naureda Llagami, si dhe Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Gent Ibrahim.

Në përputhje me nenin 149/d, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me nenin 221, pika 9, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ku përcaktohet detyrimi për të miratuar një rregullore për procedurën e hedhjes së shortit, Presidenti i Republikës ka miratuar me vendimin nr.404 datë 25.11.2019, Rregulloren “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, dokument i cili është bërë publik në faqen e institucionit para hedhjes së shortit.

Kjo rregullore qëllimonte përcaktimin e procedurave dhe rregullave të hollësishme për organizimin e shortit, nga ana e Presidentit të Republikës. Në paragrafin e parë, të nenit 2 të kësaj rregulloreje thuhet shprehimisht se, *“Hedhja e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i nënshtrohet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të këtij procesi”*. Referimi dhe përmbajtja në këto parime e këtij dokumenti vlerësojmë se përbën një element të rëndësishëm dhe thelbësor, për të realizuar korrektësisht nga ana ligjore, shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Avokati i Popullit ka kompetenca të caktuara në këtë proces, të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga ligji nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, lidhur me:

- Monitorimin (vëzhgimin) e procedurës së hedhjes së shortit, për përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së, nga ana e Presidentit të Republikës, duke hartuar dhe bërë publik një raport mbi monitorimin e kryer nga ana e tij.
- Pjesëmarrjen si vëzhgues në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (pas krijimit të tij).

---

<sup>2</sup> <http://president.al/per-hedhjen-e-shortit-per-perzgjedhjen-e-anetareve-te-keshillit-te-emerimeve-ne-drejtikesked-nga-presidenti-republikes/>

Qëndrimi institucional i Avokatit të Popullit është se, parimet e transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit të përcaktuara në pikën 9, të nenit 221, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, duhet të jenë efektive për të bërë të mundur si përcaktimin e kandidatëve të cilët do ti nënshtrohen shortimit ashtu edhe procedurën e shortimit të kandidatëve për t’u bërë anëtarë. Thënë ndryshe, shortim nuk mund të konsiderohet vetëm procedura e nxjerrjes nga kutitë e emrave fitues, por edhe ajo e futjes në kuti të emrave që plotësojnë në mënyrë korrekte kriteret e përcaktuara në ligj.

### ***3. Përmbushja e kriterëve ligjore nga kandidatët***

Një çështje që vlen të trajtohet është ajo e plotësimit të kriterëve nga kandidatët që do ti nënshtrohen shortit. Neni 221, pika 1, e ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, përcakton tetë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Ky moment shumë i rëndësishëm është theksuar edhe nga ana e Presidentit të Republikës, në njoftimin zyrtar, të publikuar në faqen “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, ku thuhet ndër të tjera se, “...do të përfshihen në short sipas ligjit, vetëm ata magjistratë (gjyqtarë ose prokurorë) dhe Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj”.

Në faqen zyrtare “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, janë publikuar ndër dokumente të tjera zyrtare që lidhen me këtë proces, edhe:

- Shkresa nr.368 datë 15.11.2019, e anëtares me kompetencat e Kryetarit të Gjykatës së Kushtetuese, zj. Vitore Tusha, drejtuar Presidentit të Republikës, me anë të së cilës dërgohet lista e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj dhe kriteret ligjore për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED.<sup>3</sup>
- Shkresa nr.901 datë 15.11.2019, e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), z. Gent Ibrahimimi, drejtuar Presidentit të Republikës, me anë të së cilës dërgohet lista e prokurorëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED. Në listën e propozuar gjenden 11 prokurorë, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe 16 prokurorë, në Prokuroritë e Apeleve.

---

<sup>3</sup> Sipas kësaj shkrese lista e dërguar përmban emrat e 5 gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe më kokretisht: zj. Vitore Tusha, anëtare me kompetencat e Kryetarit të Gjykatës së Kushtetuese, Z. Besnik Muçi, Gjyqtar, Zj. Elsa Toska, gjyqtare, Znj. Marsida Xhaferllari, gjyqtare, dhe Zj. Fiona Papajorgji, gjyqtare.

- Shkresa nr.5693 datë 15.11.2019, e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), zj. Naureda Llagami, drejtuar Presidentit të Republikës, me anë të së cilës dërgohet lista me emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të Gjykatave të Apelit dhe gjyqtarëve të Gjykatave Administrative, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED. Më konkretisht, në listën e dërguar gjenden, 1 (një) gjyqtar i Gjykatës së Lartë, 19 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë, 5 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Durrës, 6 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Shkodër, 3 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Korçë, 7 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Vlorë, 6 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, 12 gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, 2 gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Apelit Durrës, 1 gjyqtar i Gjykatës Administrative Gjirokastrë, 2 gjyqtarë të Gjykatës Administrative Gjirokastrë, 2 gjyqtarë të Gjykatës Administrative Vlorë dhe 15 gjyqtarë të Gjykatës Administrative Tiranë. Konstatohet se, lista e bashkëngjitur shkresës nr.5693 datë 15.11.2019, nuk përmban asnjë emër nga gjyqtarët e Gjykatës Administrative Shkodër.

Sikurse e kemi nënvizuar edhe në raportet tona të mëparshme për hedhjen e shorteve të zhvilluara, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pavarësisht se në vlerësimin tonë kriteret kumulative të parashikuara nga ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për kandidatët për anëtarë të KED përjashtojnë një kategori mjaft të madhe gjyqtarësh dhe prokurorësh nga e drejta për të qënë kandidatë për tu zgjedhur në KED, ato duheshin zbatuar në mënyrë rigorozë nga institucionet përkatëse, për sa kohë që ishin kriteret të parashikuara në ligj.

Një parashikim të tillë pa ekuivok përmban paragrafi 2, i nenit 221, i ligjit 115/2016, i cili parashikon shprehimisht se: *“kandidatët që nuk plotësojnë një nga këto kushte përjashtohen nga shorti”*.

Me anë të shkresës nr.4329/1 prot, datë 22.11.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Presidentit të Republikës, drejtuar Kryetarit të KLGJ-së, Kryetarit të KLP-së, si dhe për dijeni, Avokatit të Popullit, bazuar në listat e kandidatëve të përfshirë nga ana e këtyre këshillave për hedhjen e shortit për anëtarë të KED-së, kërkohet informacion për procedurat ligjore të ndjekura prej tyre, deri në këtë fazë paraprake të procesit. Më konkretisht, informacioni është kërkuar për bërjen publike në faqen zyrtare të këtyre këshillave të listave respektive të kandidatëve që plotësojnë kushtet për anëtar të KED-së, procedurës së njoftimit me shkrim të kandidatëve të përjashtuar për shkak të mosplotësimin të kushteve për anëtar të KED-së. Është kërkuar informacion edhe mbi faktin, nëse ka patur ankesa pranë Gjykatës Administrative të Apelit nga ana e gjyqtarëve/prokurorëve të përjashtuar nga kandidimi me vendimin përkatës, si dhe nëse kishte apo jo, vendime përfundimtare të formës së prerë, nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, për këto ankime.

Në përgjigjen e kthyer me shkresën nr.5849/1 prot, datë 25.11.2019, nga ana e Kryetarit të KLGJ-së, është konfirmuar se janë bërë publike në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni, listat e kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet për të'u zgjedhur anëtarë të KED, si dhe lista e kandidatëve që nuk plotësojnë këto kushte. Kandidatët e përjashtuar nga radhët e gjyqtarëve konfirmohet se janë njoftuar me shkrim, individualisht. Në përmbajtjen e kësaj shkrese jepet informacion gjithashtu, për ankimin e paraqitur nga ana e z. Medi Bici, në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe të faktit se nuk kishte ende një vendim përfundimtar nga kjo gjykatë, për këtë ankim.

Për zhvillimin e procesit të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED, me anë të shkresës nr.4468 datë 27.11.2019, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të Presidentit të Republikës, i ka drejtuar një kërkesë Kryetarit të KLGJ-së, ku kërkohet informacion shtesë mbi azhornimin e të dhënave për listat e kandidatëve të përcjella nga KLGJ.<sup>4</sup> Në mënyrë korrekte, kjo shkresë i është përcjellë për dijeni edhe Avokatit të Popullit, zj. Erinda Ballanca.

Në këtë shkresë, duke sjellë në vëmendje kushtin ligjor të përfshirjes në short të vetëm atyre kandidatëve të cilët deri në momentin e hedhjes së shortit, plotësojnë kushtet dhe kriteret 221, të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, kërkohet informacion i përditësuar nga ana e KLGJ-së, për gjyqtarët A.V. dhe A. B., të cilët kanë qënë të përfshirë në listën e kandidatëve të përcjellë nga KLGJ-ja, Presidentit të Republikës. Gjatë diferencës kohore prej 12 ditësh, të shkresës ku jepet lista e kandidatëve nga KLGJ-ja, me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Presidentit të Republikës, ku kërkohet informacion shtesë mbi azhornimin e të dhënave rezulton se kanë ndodhur zhvillime specifike, që lidhen me shkarkimin nga detyra të këtyre dy gjyqtarëve nga ana e Këshillit të Pavarur të Kualifikimit.

Po kështu, në këtë shkresë kërkohet informacion shtesë edhe për z. M. B., anëtar i Këshillit të Pavarur të Kualifikimit, i cili pasi është njohur me faktin se ndodhet në listën e kandidatëve të përjashtuar ka parashtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka përcaktuar seancën e shqyrtimit në datën 26.11.2019. Njëkohësisht, përditësim informacioni për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe kriterëve nga gjyqtarët e përfshirë në listën e dërguar nga KLGJ, me shkresën nr.5693 prot, datë 15.11.2019, është kërkuar edhe për të gjithë gjyqtarët e tjerë të kësaj liste.

Në përgjigje, me shkresën nr.5849/3 datë 4.12.2019 të Kryetarit të KLGJ-së, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, të institucionit të Presidentit të Republikës, sqarohet se emrat e gjyqtarëve z. A.V. dhe z. A. B., janë përfshirë në listën e kandidatëve për anëtarë të KED, të përcjellë me shkresën nr.5693 prot, datë 15.11.2019, pasi deri në këtë datë nuk

---

<sup>4</sup> Këto lista i janë përcjellë Presidentit të Republikës me shkresën nr.5693 prot, datë 15.11.2019 të Kryetarit të KLGJ-së.



ka patur ndonjë shkak ndalimi ligjor, për përfshirjen e tyre në listë. Vendimet e mëpasshme të Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit të nxjerra për të dy këta gjyqtarë, përbëjnë kusht ligjor ndalimi për kandidim dhe në këto rrethana në shkresë thuhet se, ata duhet të mopërfshihen në shortin për anëtarë të KED-së.

Po në këtë shkresë sqarohet në vazhdim se, për shkak të marrjes nën hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, të gjyqtarëve, A. N. dhe S- D., të përfshirë në listën e dërguar nga KLGJ-ja, për shortin e zgjedhjes së anëtarëve të KED-së, këta të fundit duhej të përjashtoheshin nga kjo listë. Për gjyqtarin tjetër Petrit Aliaj, sqarohet se është përjashtuar nga përfshirja në listën për shortin e zgjedhjes së anëtarëve të KED-së, nga ana e KLGJ-së, për shkak të njërit prej vlerësimeve të tij për anën profesionale. Lidhur me ankimin e paraqitur nga ana e z. M. B., sqarohet se Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.250 datë 26.11.2019, ka vendosur pushimin e gjykimit për këtë çështje.

Për zhvillimin e procesit të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED, me anë të shkresës nr.4468/1 datë 2.12.2019, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të Presidentit të Republikës, i ka drejtuar një kërkesë Kryetarit të KLP-së, ku kërkohet informacion shtesë mbi azhurnimin e të dhënave për listat e kandidatëve, të përcjella nga KLP-ja. Edhe kjo shkresë, i është përcjellë për dijeni Avokatit të Popullit, zj. Erinda Ballanca.

Duke sjellë në vëmendje kushtin ligjor të përfshirjes në short të vetëm atyre kandidatëve, të cilët deri në momentin e hedhjes së shortit, plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 221, të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në shkresë kërkohet informacion i përditësuar në vijëmbësi nga ana e KLP-së, deri në ditën e hedhjes së shortit, për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve nga prokurorët e përfshirë në listën e dërguar prej këtij këshilli.

Kjo kërkesë është përsëritur me shkresën nr.4552/1 datë 3.12.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm, të institucionit të Presidentit të Republikës, drejtuar Kryetarit të KLP-së.

Njëkohësisht, me anë të shkresës nr.4574 prot, datë 4.12.2019, dërguar Drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, të institucionit të Presidentit të Republikës, është kërkuar informacion mbi gjendjen e procedimit, për kallëzimin penal të paraqitur nga Presidenti i Republikës, ndaj shtetasit Ardian Dvorani (gjyqtar në Gjykatën e Lartë). Nuk kemi informacion për përgjigjen e kthyer në këtë rast.

### ***3. Monitorimi i hedhjes së shortit***

Procesi i hedhjes së shortit për anëtarë të KED, ka filluar në orën 12.00’, të datës 5 dhjetor 2019, në sallën “Skënderbej”, në selinë e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Paraprakisht, në këtë sallë janë paraqitur dhe kanë qënë prezent përgjatë gjithë zhvillimit të procedurës të hedhjes së shortit, përfaqësues nga një sërë institucionesh shtetërore, si Avokati i Popullit zj. Erinda Ballanca (dhe dy përfaqësues të tjerë institucionit), Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Gent Ibrahim, përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësues të Ambasadës së SHBA-ve në Shqipëri, përfaqësues të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, përfaqësues të organizatave partnere ndërkombëtare në cilësinë e vëzhguesve, si dhe media.

Para fillimit të procedurës në sallën ku po zhvillohej shorti, ka mbërritur edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta, i cili ka qëndruar përgjatë gjithë zhvillimit të këtij procesi.

Për procedurë, në njoftimin përkatës drejtuar Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 4520 prot., datë 2.12.2019, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, të institucionit të Presidentit të Republikës, është kërkuar pjesëmarrja nga ana e Avokatit të Popullit, në hedhjen e shortit për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me cilësinë e vëzhguesit të kësaj procedure.

Procesi i zhvillimit të shortit u facilitua nga ana e këshilltarit ligjor të Presidentit të Republikës, z. Bledar Dervishaj. Gjatë hapjes formale të procesit, z. Dervishaj bëri një prezantim të shkurtër të rëndësisë së KED-së, procedurave të krijimit të tij, përbërjes, kompetencave që i jepen nga Kushtetuta dhe nga legjislacioni në fuqi, si dhe të kritereve ligjore që duhet të përmbushë çdo kandidat deri në momentin e hedhjes së shortit, për t'u përfshirë në këtë të fundit.

Në sqarimet e dhëna nga ana e z. Dervishaj gjatë fjalës hapëse të procesit ka theksuar edhe përjashtimin nga ky proces, të gjyqtarëve dhe prokurorëve të përfshirë në listat e kandidatëve për shortin e zgjedhjes së anëtarëve të KED-së, të cilët deri në datën 5.12.2019, kanë patur shkak ndalimi ligjor dhe rrjedhimisht mosplotësim të kushteve dhe kritereve ligjore, për të qënë pjesëmarrës në të.

Pas verifikimit fizik të goglave plastike me të cilat do të hidhej shorti është kaluar në zhvillimin e procesit, për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED.

Për hedhjen e shortit, mbi bazën e Vendimit nr.403 datë 25.11.2019, të Presidentit të Republikës ishte krijuar një Sekretari Teknike, e caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm, i institucionit të Presidentit të Republikës, me përbërje të nëpunësve civilë të këtij institucioni. Për këtë procedurë u përdorën disa enë qelqi transparente, ku ishin të vendosura goglat sipas numrit të kandidaturave të dërguara në shkresat përkatëse të institucioneve shtetërore propozuese. Ndërkohë u përdor një kuti transparente me mekanizëm rrotullues (e cila fillimisht ishte bosh), ku vendoseshin goglat në të cilat ishin futur shiritat e letrës të shënuara me emrat e kandidatëve të propozuar nga secili institucion, sipas listës përkatëse të përcjellë Presidentit të Republikës së Shqipërisë, prej

tyre. Fillimisht shiritat e letrës me emrat e kandidatëve sipas institucioneve përkatëse që merrnin pjesë në short, ishin vendosur në një kuti transparente të veçantë. Procesi teknik i hedhjes së shortit u facilitua edhe nga dy punonjëse të tjera të institucionit të Presidentit të Republikës, të cilat kryenin pikërisht veprimet e sipërcituara teknike.

Shiritat e letrës më emrat e kandidatëve pasi u lexuan publikisht edhe në praninë e mediave u futën në gogla dhe rradha e hedhjes së shortit u përcaktua duke u mbështetur në renditjen e mëposhtme:

- Kandidatë nga Gjykata Kushtetuese
- Kandidatë nga Gjykata e Lartë;
- Kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme.
- Kandidatë nga Gjykatat e Apelit;
- Kandidatë nga Zyrat e Prokurorisë, pranë Gjykatave të Apelit;
- Kandidatë nga Gjykatat Administrative.

1. Procedura e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata Kushtetuese u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve të kësaj gjykate, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr. 368 datë 15.11.2019, të anëtares me kompetencat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Kushtetuese (5 kandidatë sipas listës përkatëse), punonjësja e institucionit të Presidentit të Republikës, facilituese e procesit teknik të hedhjes së shortit, pasi bëri përzierjen e goglave, në mënyrë rastësore tërhoqi emrin e një kandidati dhe e lexoi me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 5 gjyqtarëve, që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedhën anëtarë të KED-së, përkatësisht:

- Fiona Papajorgji (anëtar)
- Vitore Tusha (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, dhe më konkretisht;

- Marsida Xhaferllari (anëtar zëvendësues).

2. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Lartë nuk u zhvillua për shkak se, nga ana e kësaj gjykate ishte në konkurim vetëm një emër, i cili “*ipso-jure*” u konsiderua anëtar i KED-së, pa nevojën për hedhjen e shortit përkatës. Konkretisht, u caktua anëtar i KED-së, gjyqtari Ardian Dvorani.

Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve zëvendësues, procedura nuk u zhvillua, pasi nuk kishte gjyqtarë të tjerë që plotësonin kriteret ligjore për përfshirjen në këtë short.

3. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme (11 kandidatë sipas listës përkatëse, të përcjellë në shkresën nr.901 prot, datë 15.11.2019 të Kryetarit të KLP-së, drejtuar Presidentit të Republikës), punonjësja e institucionit të Presidentit të Republikës, lehtësuese e procesit teknik të hedhjes së shortit, pasi bëri përzierjen e goglave, në mënyrë rastësore tërhoqi emrin e një kandidati dhe e lexoi me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të KED.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 11 prokurorëve që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjodh anëtar i KED-së:

- Arta Marku<sup>5</sup> (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme, dhe më konkretisht;

- Bilbil Mete (anëtar zëvendësues).

4. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat e Apelit u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve të këtyre gjykateve, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr. 5693 prot. datë 15.11.2019, të Kryetarit të KLGJ-së, drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat e Apelit (48 kandidatë sipas listës përkatëse), punonjësja e institucionit të Presidentit të Republikës, facilituese e procesit teknik të hedhjes së shortit, pasi bëri përzierjen e goglave, në mënyrë rastësore tërhoqi emrin e një kandidati dhe e lexoi me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të KED.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 48 gjyqtarëve që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjodh anëtar i KED-së:

- Miranda Andoni (anëtar)
- Saida Dollani (anëtar)

---

<sup>5</sup> Sqarojme se ne momentin e hedhjes se shortit,Znj. Marku ishte ende në detyren e Prokurores së Përgjithshme të Përkohëshme dhe se zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm të ri u bë nga Kuvendi në po këtë datë por në një orë të mevonshme.

Me të njëjtën procedurë shorti u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtarë të Gjykatave të Apelit, dhe më konkretisht;

- Nazmi Troka (anëtar zëvendësues)

5. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit, u zhvillua ndërmjet emrave të prokurorëve, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr.901 prot, datë 15.11.2019 të Kryetarit të KLP, drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit (16 kandidatë sipas listës përkatëse), punonjësja e institucionit të Presidentit të Republikës, facilituese e procesit teknik të hedhjes së shortit, pasi bëri përzierjen e goglave, në mënyrë rastësore tërhoqi emrin e një kandidati dhe e lexoi me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të KED.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 48 gjyqtarëve që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedh anëtar i KED-së:

- Z. Ludovik Dodaj (anëtar)
- Zj. Fatjona Memçaj (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, prokuror në Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit, dhe më konkretisht;

- Z. Nezir Gjokaj (anëtar zëvendësues)

6. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat Administrative u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve, të konfirmuar në listën nominale, të dhënë në shkresën nr. 5693 prot. datë 15.11.2019, të Kryetarit të KLGJ-së, drejtuar Presidentit të Republikës.. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat Administrative (34 kandidatë sipas listës përkatëse), punonjësja e institucionit të Presidentit të Republikës, facilituese e procesit teknik të hedhjes së shortit, pasi bëri përzierjen e goglave, në mënyrë rastësore tërhoqi emrin e një kandidati dhe e lexoi me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sallë. Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, iu dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të KED.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 34 gjyqtarëve që plotësonin kushtet ligjore për tu përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedh anëtar i KED-së:

- Z. Arjan Qafa (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtar në Gjykatat Administrative, dhe më konkretisht;

- Zj.Marjana Velçani (anëtar zëvendësues)

Sipas përkatësisë së hedhjes së shortit referuar institucionit nga vinin kandidatët garues, për audiencën që ndiqte këtë procedurë shfaqej paraprakisht në një ekran të madh elektronik, lista e kandidatëve të propozuar që plotësonin kushtet ligjore për të përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED.

Në përfundim të këtij procesi, u përzgjedhën 9 anëtarë të KED, dhe 5 anëtarë zëvendësues.

Në përputhje me pikën 6, të nenit 284, të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, në faqen zyrtare “on line”, të institucionit të Presidentit të Republikës, është publikuar edhe një përmbledhje e procesverbalit, për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vitin 2020.

Hedhja e shortit është transmetuar direkt nga ana e Televizionit Publik Shqiptar, si dhe media të tjera, prezente në ambientin ku po zhvillohej hedhja e shortit.

Në përfundim të hedhjes së shortit, u shpallën emrat e anëtarëve të KED, të përzgjedhur nga shorti, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues, si vijon:

#### **Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:**

1. Zj. Fiona Papajorgji nga Gjykata Kushtetuese
2. Zj. Vitore Tusha nga Gjykata Kushtetuese
3. Z. Ardian Dvorani nga Gjykata e Lartë
4. Zj. Arta Marku nga Prokuroria e Përgjithshme
5. Zj. Miranda Andoni nga Gjykatat e Apelit
6. Zj. Saida Dollani nga Gjykatat e Apelit
7. Z. Ludovik Dodaj nga Zyra e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
8. Zj. Fatjona Memçaj nga Zyra e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
9. Z. Arjan Qafa nga Gjykatat Administrative

#### **Anëtarët zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

1. Zj. Marsida Xhaferllari nga Gjykata Kushtetuese
2. Z. Bilbil Mete nga Prokuroria e Përgjithshme
3. Z. Nazmi Troka nga Gjykata e Apelit
4. Z. Nezir Gjoka nga Zyra e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
5. Zj. Marjana Velçani (Idrizi) nga Gjykatat Administrative.

**AVOKATI I POPULLIT**

**ERINDA BALLANCA**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Erinda Ballanca". The signature is written in a cursive style with a large initial 'E'.